



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
SP-032
Prishtinë, më 18 maj 2018, në orën 16:00

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 18 MAJ 2018**

Seancën e kryesoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 17 maj 2018.

Kryetari procedoi me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Përzgjedhja e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët që para se të procedohet me shqyrtimin e kësaj pike duhet të bëhet me shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim propozimin për shmangien nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 88,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Përzgjedhja e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, bëhet me procedurë të përsheptuar - shmangie nga afati procedural i paraparë me nenin 15, paragrafi 7 të Rregullores e Kuvendit.

* * *

Kryetari e deputeten Safete Hadërgjonaj, që në emër të Komisionit të posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, ta paraqesë dhe e arsyetojë raportin me kandidatët e propozuar, diskutimi i së cilës është i dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryetari kërkoi nga përfaqësuesit e deputetëve nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë që të deklarohen për dy kandidatët tjetër.

Kryetari i GP të Listës serbe, Slavko Simiq, nga radhët e komunitetit serb, u deklarua për kandidatin Radomir Laban.

Deputetja Duda Balje, në emër të GP “6+” nga radhët e komuniteteve tjera që nuk janë shumicë, u deklarua për kandidatin Bajram Latifi.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari kërkoi nga deputetët e komuniteteve që nuk janë shumicë që me votim të deklarohen për dhënien e pëlqimit për dy kandidatët tjerë për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Pas votimit, kryetari konstatoi se me 19 vota për, 1 kundër dhe asnjë abstenim, deputetët nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë e dhanë pëlqimin për dy kandidatët tjerë të propozuar për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese: Radomir Laban dhe Bajram Latifi.

Në vazhdim, kryetari i sqaroi procedurat e veçanta, të parapara në nenin 114 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për përzgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe propozoi që pasi me Kushtetutë dhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese nuk është e përcaktuar procedura e votimit në seancë plenare, të miratohet procedura e votimit për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Kryetari i hodhi në votim procedurat e votimit për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Rezultat i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 98,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 2.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Votimi i kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, bëhet me dy fletëvotime: Një fletëvotim me tetë (8) kandidatë dhe një fletëvotim me dy (2) kandidatë tjerë.
2. Votimi i kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës bëhet votim të fshehtë.
3. Deputeti i Kuvendit, prej tetë (8) kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, të rekomanduar nga Komisioni i posaçëm, voton për tre (3) kandidatë për pozitën e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese.
4. Nëse në votimin e parë, asnjëri kandidat nuk e merr numrin e nevojshëm të votave, 2 kandidatët që kanë marrë më së paku vota hiqen nga lista dhe votimi përsëritet me 6 kandidatë për 3 pozita.
5. Nëse në votimin e parë, vetëm 1 kandidat e merr numrin e nevojshëm të votave, 3 kandidatët që kanë marrë më së paku vota hiqen nga lista dhe votimi përsëritet me 4 kandidatë për 2 pozita.
6. Nëse në votimin e parë, vetëm 2 kandidatë e marrin numrin e nevojshëm të votave, 4 kandidatët që kanë marrë më së paku vota hiqen nga lista dhe votimi përsëritet me 2 kandidatë për 1 pozitë.
7. Procedura e votimit për dy (2) kandidatët tjerë për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese:
 - 7.1. Deputeti i Kuvendit, prej 2 kandidatëve tjerë për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, voton për 2 kandidatë për pozitën e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese.
 - 7.2. Nëse në votimin e parë, vetëm 1 kandidat e merr numrin e nevojshëm të votave, për kandidatin tjetër përsëritet konkursi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Në vazhdim, kryetari kërkoi nga grupet parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues për t'i zhvilluar procedurat e votimit të fshehtë.

Me propozimin e grupeve parlamentare, Kuvendi e emëroi Komisionin votues në këtë përbërje:

1. Driton Selmanaj, GP - LDK,
2. Nezir Çoçaj, GP - PDK,
3. Salih Zyba, GP - LVV,
4. Besa Baftiu, GP - PSD,

5. Rasim Selmanaj, GP -AAK,
6. Jelena Bontiq, GP - Lista serbe,
7. Enver Hoti, GP - Nisma dhe
8. Duda Balje, GP - “6+”.

Pastaj, kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit votues që të fillojnë me procedurat e votimit të fshehtë dhe i ftoi deputetët sipas listës për të votuar.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit të fshehtë, në rundin e parë, në emër të Komisionit votues rezultatin e votimit për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese e paraqiti deputetja Besa Baftiu.

I. Për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, rezultati i votimit ishte, si në vijim:

- Në votim kanë marrë pjesë 115 deputetë.
- Të pavlefshme ishin 2 vota.

Votat e fituara nga kandidatët e propozuar për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese ishin, si në vijim:

1. Nexhmi Rexhepi ----- 60 vota,
2. Resmije Istrefi-Peci ----- 75 vota,
3. Hajzer Salihu ----- 40 vota,
4. Safet Hoxha ----- 51 vota,
5. Shkëmb Manaj ----- 48 vota,
6. Vigan Qorolli ----- 37 vota,
7. Shqipe Ibraj-Mala ----- 11 vota,
8. Nebojsa Boriçiq ----- 00 vota.

II. Për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë tjerë të Gjykatës Kushtetuese, rezultati i votimit ishte, si në vijim:

- Në votim kanë marrë pjesë 115 deputetë.
- Të pavlefshme ishin 23 vota.

Votat e fituara nga kandidatët e propozuar për gjyqtarë tjerë të Gjykatës Kushtetuese ishin, si në vijim:

1. Radomir Laban ----- 71 vota,
2. Bajram Latifi ----- 58 vota.

Pas komunikimit të rezultateve të votimit në rundin e parë, kryetari konstatoi se në bazë të rezultateve të votimit asnjëri kandidat i propozuar për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese nuk i mori votat e nevojshme, në bazë të proceduarave të votimit të miratuara nga Kuvendit,

andaj, dy (2) kandidatët (Shqipe Ibraj-Mala dhe Nebojsh Boriçiq), që kanë fituar më së paku vota hiqen nga fletëvotimi i raundit të dytë dhe votimi përsëritet me gjashtë (6) kandidatët tjerë për tri pozitat (Resmije Istrefi-Peci, Nexhmi Rexhepi, Safet Hoxha, Shkëmb Manaj, Hajzer Salihu dhe Vigan Qorolli).

Për kandidatët e propozuar për gjyqtarë tjerë të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për përzgjedhjen e dy (2) gjyqtarëve tjerë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Z. Radomir Laban dhe z. Bajram Ljatifi i propozohen Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e gjyqtarëve tjerë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Raundi i dytë i votimit:

Kryetari i ftoi deputetët një nga një që të votojnë për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit të fshehtë në rundin e dytë, në emër të Komisionit votues, rezultatin e votimit për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese e paraqiti deputetja Besa Baftiu.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

- Në votim morën pjesë 108 deputetë.

Votat e fituara nga kandidatët e propozuar për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese ishin, si në vijim:

1. Resmije Istrefi-Peci ----- 58 vota,
2. Nexhmi Rexhepi ----- 60 vota,
3. Safet Hoxha ----- 59 vota,
4. Hajzer Salihu ----- 35 vota,
5. Shkëmb Manaj ----- 42 vota,
6. Vigan Qorolli ----- 19 vota.

Pas komunikimit të rezultateve të votimit në raundin e dytë, kryetari konstatoi që Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për mos përzgjedhjen e tre (3) gjyqtarëve në Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

1. Asnjëri kandidat i propozuar nga Komisioni i posaçëm për përzgjedhjen e kandidaturave për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese: Nexhmi Rexhepi, Remzije Istrefi-Peci, Hajzer Salihu, Safet Hoxha, Shkëmb Manaj, Vigan Qorolli, Shqipe Ibraj-Mala dhe Nebojsha Boriçiq nuk i mori votat e nevojshme për t'ia propozuar Presidentit të Republikës së Kosovës për emërim gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
2. Thirrja publike (konkursi) përsëritet për tre (3) gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 20:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*